



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.8/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Nënkryetaren e Gjykatës Nushe Kuka Mekaj, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit V.M, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga F.H.Z, avokate nga Peja, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 18.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga F.H.Z, avokate nga Peja, ndaj gjyqtarit V.M, **SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Me parashtrësën e datës 20.09.2023, F.H.Z, avokate nga Peja, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit V.M për shkelje të ligjit, me arsyetimin se në lëndën C.nr.1767/20, me bazë juridike kompensim dëmi, është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor me datë 21.08.2023, në të cilën seancë për paditësin A.M, të cilin këtu parashtruesja e ankesës e përfaqëson sipas autorizimit, është paraqitur me autorizim zëvendësues praktikantja e zyrës së saj NJ.H, të cilën gjyqtari nuk e ka pranuar me arsyetimin se në këtë fazë të procedurës nuk lejohet të përfaqësohet me autorizim zëvendësues dhe seanca është shtyrë për datë 06.09.2023, duke i ftuar të gjithë ekspertët për pjesëmarrje në seancë pa e cekur në procesverbal se cila palë e ka bërë një propozim të tillë, në këtë mënyrë duke bërë shkelje nga neni 90 par.4 të LPK-së, ku ceket se “avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë”, po ashtu, i njëjti jashtë procesit praktikantes i është drejtuar me fjalët “ajo zoja ka mujt me bo autorizim bartës në momentin kur e ka bo zëvendësues, e tregoj asaj se qështu i tërheket padia si tu nejt” dhe seancën gjyqësore e ka shtyrë duke konstatuar në proces se nuk mund të përfaqësohet me autorizim zëvendësues në seancën e shqyrtimit kryesor mirëpo, këtu parashtruesja e ankesës thekson se kjo seancë nuk është shtyrë për shkak të lehonisë së saj, por për shkak të bindjes së gabuar të gjyqtarit. Andaj, konsideron se sjellja e tillë është joetike nga ana e gjyqtarit kur ligji nuk parasheh se autorizimi mund ti bartet një personi tjetër i cili nuk është avokat, e me këto veprime gjyqtari ka shkel nenin 40 par.2 të Ligjit për Gjykatat. Po ashtu, meqenëse e njëjta nuk ka mund të marrë pjesë në seancën e datës 06.09.2023, me datë 25.08.2023 ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën për shtyrje të seancës duke e njoftuar gjyqtarin se është në pushim të lindjes dhe duke e dorëzuar certifikatën e lindjes si provë dhe pavarësisht faktit se gjyqtari ka pas kohë mjaftueshëm për t’i njoftuar palët dhe ekspertët për mosmbajtjen e seancës, i njëjti ka zgjedhur ta vazhdoj procedurën dhe në seancë, në mungesën e saj ka marrë aktvendim me të cilin e ka detyruar paditësin që secilit ekspert veç e veç t’ia paguaj shpenzimet për pjesëmarrje në seancë, me konstatimin se edhe seanca e datës 21.08.2023 është shtyrë për fajin e të autorizuarës së paditësit për shkak të pushimit të lehonisë mirëpo, shqyrtimi nuk mund të prolongohet në afate të pacaktuara për këtë rrethanë, për shkak se e njëjta autorizimin mund ta bartte personi tjetër. Gjyqtari me rastin e nxjerrjes së aktvendimit nuk e ka marrë parasysh faktin se konform nenit 49 par.1 të Ligjit të Punës, pushimi i lehonisë parashihet për së paku 6 muaj si dhe

me asnjë dispozitë nuk është paraparë fakti se është e detyruar ta bëjë bartjen e autorizimit, ngase personi tjetër mund të mos e pranojë një autorizim të tillë. Përfundimisht, vendimin e tillë e vlerëson si të jashtëligjshëm dhe i ka propozuar autoritetit kompetent që ndaj gjyqtarit të ndërmerren masa disiplinore ashtu që në të ardhmen të ketë sjellje adekuate që i përshtaten pozitës së tij dhe detyrat e tij të kryej me kohë dhe me paanshmëri.

Parashtruesja e ankesës disiplinore, si provë ankesës së saj ia ka bashkëngjitur: Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1767/20, të datës 06.09.2023, Procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 06.09.2023 dhe Procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 21.08.2023.

Me datë 22.09.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga F.H.Z, avokate nga Peja, ndaj gjyqtarit V.M.

Gjyqtari V.M, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim, lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se ndonëse është e paqartë se në çfarë shkelle disiplinore konsistojnë veprimet e tij si gjyqtar pasi që ankesa disiplinore në tërësinë e saj paraqet vetëm një tregim lidhur me veprimet procedurale të ndërmarra lidhur me lëndën C.nr.1767/20 dhe pretendimet e parashtrueses së ankesës, në rastin më të mirë mund të atakohen me vendim përfundimtar megjithatë, ka sqaruar se me nenin 90 të LPK-së janë përcaktuara vëllimet e autorizimeve të përfaqësuesit me prokurë, në të cilin rast e autorizuar është avokatja F.H.Z. Fillimisht, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 21.08.2023, është paraqitur zonja N.J.H me autorizim zëvendësues, e cila në seancë është paraqitur në cilësi të asistentes së avokates e jo në cilësi të praktikantes së saj. Si provë për këtë bashkëngjitur deklaratës, ka dorëzuar shkresën me titull “Autorizim Zëvendësues”. Në këtë drejtim ka sqaruar se neni 90.2 i LPK-së, ka përcaktuar se *“Në qoftë se pala ia ka dhënë prokurën për ndjekjen e çështjes në gjyq personit që është avokat, por pa i caktuar më për së afërmi autorizimet e tij, avokati në bazë të prokurës së këtillë është i autorizuar që: d) ta autorizojë avokatin tjetër me shkrim që të kryejë disa veprime të caktuara procedurale, por jo edhe që të veprojë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes”* dhe se në rastin konkret avokatja në autorizimin e saj burimor, nuk kishte klauzolë të veçantë për autorizimin e personave të tretë pra, sipas LPK-së nuk ka mundur t’i autorizoj zonjën Nj. për përfaqësim, e cila para gjyqtarit është paraqitë në cilësinë e asistentes, e jo në cilësinë e praktikantes apo avokates, pasi në autorizimin e paraqitur shumë qartë ka shkruar se është asistente e avokates në fjalë. Lidhur me deklaratën e parashtrueses së ankesës se gjyqtari i është drejtuar me disa fjalë jashtë procesit, i njëjti ka deklaruar se pretendimi i tillë nuk qëndron sepse ajo që ka pas për të deklaruar në këtë rast është konstatuar në proces kurse, jashtë procesit nuk janë thënë fjalët që pretendon e njëjta. Po ashtu, ka sqaruar se seanca e datës 21.08.2023, nuk është shtyrë si rezultat i bindjes së tij si gjyqtar, por si pasojë e dispozitave ligjore të lartcekura ndërsa, lidhur me pretendimin e parashtrueses së ankesës se 12 ditë para seancën e ka njoftuar gjykatën se është në pushim të lindjes, gjyqtari ka theksuar se i njëjti nuk mund të anulohet seanca para se të marrë edhe mendimin e palës tjetër. Lidhur me kompensimin e ekspertëve, gjyqtari ka theksuar se kjo është një çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe se një ankesë në këtë drejtim mund të gjej vend në vendimin përfundimtar, e jo në ankesë disiplinore. Gjyqtari M., ka theksuar se është e pakuptimtë dhe kontradiktore kur avokatja thekson se nuk mund të bartë autorizimin te personat e tretë për shkak se pala e saj mund të mos pajtohet, por si ka mund të atëherë po e njëjta avokate që pa marrë pëlqimin e palës së saj të autorizoj zonjën Nj.? Lidhur me çështjen e lehonisë së avokates Hoxha Zymberaj, gjyqtari ka theksuar se seanca e datës 06.09.2023, është shtyrë pikërisht për këtë fakt se e njëjta është në pushim të lehonisë, ashtu që as ajo e as pala e saj nuk kanë humbur asnjë mundësi procedurale që ju garanton ligji, për më tepër Ligji Nr.04/L-193 për Avokatinë, me nenin 37 par.1 pika 1.2, ka paraparë kohën kur avokati mund të kërkojë përkohësisht pezullimin e

përkohshëm të ushtrimit të avokatisë, e që një ndër arsyet është edhe pushimi i lehonisë andaj, nëse avokatja konsideron se nuk mund të prezantohet në seancë për shkak të pushimit të lehonisë, situata e tillë është e rregulluar me ligj, por pala e saj në këtë rast nuk mund të pësojë si rezultat i saj dhe lënda e tij të mbetet e pashqyrtuar. Në këtë pikë, gjyqtari ka sqaruar se avokatja në fjalë ka prezantuar në gjykatë edhe pas seancës së datës 06.09.2023, në lëndën C.nr.897/20 pikërisht në zyrën e gjyqtarit pra, e njëjta ose është në pushim lehonie vetëm për seancat të cilat i zgjedh vetë ajo ose këtu bëhet fjalë për një gjë të pakuptueshme sepse nuk mundësh që aty ku të konvenon të marrësh pjesë në seanca e ku nuk të konvenon të dërgosh parashtruesja se je në pushim lehonie. Përfundimisht, ka theksuar se konsideron se asnjë veprim i tij si gjyqtar nuk është i përfshirë në shkelje disiplinore nga neni 5 par.1.2 dhe neni 2 par.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ngase është i bindur se e ka zbatuar ligjin kur nuk ka lejuar që në seancë të prezantohet persona të cilët ligji nuk i lejon dhe se është i përkushtuar që lëndën t'a procedoj tutje pa prolongime sepse është obligim i tij ligjor dhe ka autorizime ligjore dhe kushtetuese që të kujdeset që personat të përfaqësohen përmes të autorizuarve të tyre me prokurë, të mos lejoj që të drejtat e tyre të keqpërdoren dhe çështja e tyre të mos marrë epilog. Andaj, ka propozuar që pas shqyrtimit të kësaj deklarate, të refuzohet propozimi i parashtrueses së ankesës për inicim të procedurës disiplinore ndaj tij ashtu që ankesa disiplinore të refuzohet si e pabazuar.

Nënkryetarja e Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit V.M, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e parashtrueses së ankesës për shkelje disiplinore nga gjyqtari V.M, dhe atë për shkelje disiplinore nga neni 5 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse ai apo ajo: 1.2 shkel ligjin), mbështetur në faktin se gjyqtari ka shkel nenin 90 par.4 të LPK-së, sipas së cilit “90.4 Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë.” për shkak se në seancën gjyqësore të datës 21.08.2023, në vend të të autorizuarës së palës paditëse, këtu parashtrueses së ankesës, është paraqitë praktikantja e zyrës së saj me autorizim zëvendësues, të cilën gjyqtari nuk e ka pranuar me arsyetimin se në këtë fazë të procedurës nuk lejohet të përfaqësohet me autorizim zëvendësues, e po ashtu, ka shkelë nenin 40 par.2 të Ligjit për Gjykatën, sipas së cilit “Gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, gjyqtarët demonstronjë disponueshmërinë, respektin për palët dhe dëshmitarëve si dhe vigjilencë në ruajtjen e shkallës më të lartë të kompetencës”, me çka ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5 par.2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Shkelje të detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshijnë veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: 2.2 nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë;”, për shkak se i njëjti i është drejtuar praktikantes së saj me fjalët “ajo zoja ka mujt me bo autorizim bartës në momentin kur e ka bo zëvendësues, e tregoj asaj se qeshtu i tërheket padia si tu nejt”, autoriteti kompetent gjen se fillimisht, nga autorizimi që gjendet në shkresat e lëndës C.nr.1767/20, i nënshkruar nga këtu parashtruesja e ankesës avokatja Filloreta Hoxha Zymeraj, në cilësinë e autorizimdhënëses, me titull “Autorizim Zëvendësues”, drejtuar gjyqtarit të çështjes V.M, i nënshkruar me datë 21.08.2023, qëndron konstatimi si në vijim, citoj “Me të cilin e autorizoj Asistenten time znj. NJ.H, që të më zëvendësojë në seancën gjyqësore e cila është paraparë të mbahet me datë 21.08.2023, në ora 13:15, në Gjykatën Themelore në Pejë...” andaj, parashtruesja e ankesës nuk mund të thirret në faktin se e njëjta e ka autorizuar praktikanten e saj që t'a zëvendësojë në seancë kur në vetë autorizimin zëvendësues të nënshkruar nga ana e saj është konstatuar se bëhet fjalë për asistenten e zyrës, e jo praktikanten ndërsa, në raport me pretendimin se gjyqtari i është drejtuar praktikantes së saj, jashtë procesit me fjalët se “ajo zoja ka

mujt me bo autorizim bartës.....se qeshtu i tërheket padia si tu nejt”, autoriteti kompetent gjeti se pretendimi i tillë nuk është argumentuar me asnjë provë.

Autoriteti kompetent vlerëson se ankesa disiplinore në përgjithësi mbështetet në përshkrim të veprimeve procedurale të ndërmarra nga ana e gjyqtarit dhe pakënaqësitë e shprehura nga e autorizuara e palës së paditur, këtu parashtrueses së ankesës, ndaj veprimeve të marra nga gjyqtari me qëllim të drejtimit të procedurës, veprime këto të cilat nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore mirëpo, të njëjtat janë pretendime ankimore të cilat eventualisht mund t'i parashtrojnë palët ndërgjyqëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pasi veprimet e tilla procedurale të gjyqtarit janë subjekt i vlerësimit të gjykatave të shkallëve më të larta, si gjykata kompetente për vlerësimin e saktësisë dhe ligjshmërisë së vendimeve të gjyqtarëve.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.8/23, me datë 18.10.2023

Nënkryetarja e Gjykatës

Nushe Kuka Mekaj

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit V.M*
- 3. Parashtrueses së ankesës – F.H.Z, avokate në Pejë.*